



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Liqenit p.n. - 40000 Mitrovicë
DATA: 11.08.23 NR.: 1134

Bordi i Drejtoreve të KRU''Mitrovica'' Sh.A bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligji Nr.05/L-009, nenit 4 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212, si dhe bazuar në nenin 7 në Statutin e Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale Ujësjellësi ''Mitrovica'' Sh.A në mbledhjen e mbajtur me datë 11.08.2023 aporvoi këtë:

RREGULLORE NR. 1134 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.1347/2 MBI SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS DHE ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË PUNËVE DHE DETYRAVE TË PUNËS TË KOMPANISË RAJONALE UJËSJELLËSI ''MITROVICA'' SH.A. NË MITROVICË:

Neni 1

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullore nr.1347/2 mbi sistematizimin e vendeve të punës dhe organizimin e brendshëm të punëve dhe detyrave të punës te KRU,, Mitrovica,, Sh.A

Neni 2

Neni 19 , riformulohet dhe i shtohet teksti:

Pozitat Menaxheriale pas nënshkrimit të kësaj Rregullore do te emërohen me mandat 1 (një) vjeçar me mundësi vazhdimi duke pasur parasysh performancën pozitive të treguar në punë.

Këtu përfshihen pozitat nga grupi A3 deri A5, bazuar në rregulloren për ndarjen e të ardhurave personale të KRUM me nr 1347/3 e dates 27.12.2022.

Neni 3

Plotësohet Rregullorja mbi sistematizimin e Vendeve të Punës me pozitën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të punë:

Pozita- Inxhinier përgjegjës- Hidroteknikë

Përgatitja profesionale: Fakulteti Teknik - Hidroteknikë

Përvoja e punës: 2 vite

Aftësitë e buta: aftësitë e mira të komunikimit, etikën e punës, punën ekipore, vendimmarrjen, menaxhimin e kohës, motivimin, fleksibilitetin, zgjidhjen e problemeve dhe mendimin kritik.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës:

- Punon në kalkulimin e çmimeve për paramasë dhe parallogaritë dhe përgatit apo kompletion dokumentet për projektet e ujësjellësit (kompletimin e tenderit)
- Bashkëpunon me shërbimet dhe departamentet tjera e sidomos me zyrën e GIS-it në KRU Mitrovica,

- Pas kordinimit të punëve në zyre, të planifikimit dhe punimit të projekteve sipas kërkesës së shërbimeve obligohet të përcillen zhvillimet e punimeve edhe në teren,
- Përgadit tërë dokumentacionin teknik për kryerjen e punëve dhe të njejtin ia dërgon Shefit të shërbimit të projektimit dhe zyrës së GIS-it.
- Bashkëpunon dhe koordinon punën me stafin inxhinierik dhe GIS në hartimin e projekteve investive në fushën e Hidroteknikës.
- Bënë mbikëqyrjen e implementimit të projekteve.
- Për mirëmbajtjen dhe operimin e rregullt të aseteve të kompanisë bën plane për tu përgjigjur në çdo sfidë siç janë planet reaktive, pro aktive dhe preventive.
- Bënë planin e punës, planin vjetor dhe të remonteve të mirëmbajtjes së objekteve në pikëpamje investive dhe të rregullt nëse është e aplikueshme duke paraparë materialin e nevojshëm dhe pjesët e ndërrimit
- Formon dokumentacionin e rregullt dhe kujdeset për ruajtjen e tij;
- Është përgjegjës ndaj ligjeve shtetërore që rregullojnë veprimtarinë nga lëmitë e profileve të këtij shërbimi dhe kujdeset që ti marrë masat gjegjëse sidomos nga mbrojtja higjieno - teknike dhe të mbrojtjes në punë;
- Evidenton defektet dhe dëmtimet në rrjetin e ujësjellësit në pronësi të KRU-së deri te prona e konsumatorit, dhe merr masa preventive që me kohë të eliminohen këto
- defekte dhe dëmtime deri në funksionimin e rregullt të rrjetit që furnizon konsumatorët e tërë rrjetit, si dhe pas evidentimit i rexhistron ato në sistemin GIS
- Përpilon planin e zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë si dhe zgjerimin e rekonstruimin e objekteve të KRU-së , në mënyrë që të sigurohet funksionaliteti dhe efikasiteti i plotë i punës së tij;
- Në kuadër të vet dhe në kuadër tjetër plotësues projektin objekte hidroekonomike dhe hidrondërtimore për Kompaninë dhe për palët e treta dhe me mjetet e veta ose plotësuese i realizon ato kur të sigurohen mjetet financiare;
- Pranon punë dhe përgjegjësi të tjera nga udhëheqësit konform nevojave të kompanisë.
- Kryen punë të tjera dhe i raporton Shefit të shërbimit dhe Menaxherit të Departamentit.

Neni 4

Me këtë Rregullore bëhet ndryshim plotësimi i rregullores përkatëse, për tu harmonizuar me plotësimet e përdorura në këtë Rregullore.

Neni 5

Kjo Rregullore hynë në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve të KRU,, Mitrovica,, Sh.A.- Mitrovicë si dhe publikimit të saj në ueb-faqen e Kompanisë.

KRU,, Mitrovica, Sh.A. - Mitrovicë

Kumrije Kelmendi Aliu - Kryesuese e Bordit të Drejtorëve

